

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

Dega: BACHELOR NË TEKNIK IMAZHERI-RADIOLOGJI

KOHE-ZGJATJA E STUDIMEVE 3 vjet

PROVIME DIPLOME

HYRJE

Programi i studimeve 3 vjeçare te kursit te plote te **Teknik Imazheri-Radiologji** permban 57 lende. Diplomimi i pare sipas zbatimit te Kartes se Bolonjes eshte kursi 2006-2009.

Ne fund te studimeve Fakulteti i Infermierise i Universiteti te Tiranes jep titullin "**Teknik Imazheri-Radiologji**".

Kurrikula e plote permban 4500 ore mesimore 60 minuteshe nga te cilat **1575 ore praktike** ne institucionet spitalore te Qendres Universitare "Nene Tereza" dhe ne Sherbimin Shendetsor Primar. **2925 ore jane mesim aktiv ne auditor**.

Nje vit akademik ndahet ne 2 semestra dhe lendet jane te grupuara ne module, me nje total prej 60 kreditesh; 30 kredite semestri i pare dhe 30 kredite semestri i dyte.

1 kredit = 25 ore, nga te cilat 12 ore jane mesim aktiv ne fakultet dhe 13 ore jane pune e pavarur e studentit.

Ne vitin e pare akademik studentet kryejne 18 jave mesimore ne semestrin e pare dhe 14 jave mesimore ne semestrin e dyte. Gjate semestrit te pare studentet kane 2 jave pushime per Krishtlindjet dhe 1 jave provime nga 21–28 shkurt. Gjate semestrit te dyte studentet kane 14 jave mesim, 5 jave praktike dhe 2 jave provime nga 20 qershor– 4 korrik.

Ne vitin e dyte akademik studentet kryejne 10 jave mesimore ne semestrin e pare, 8 jave praktike, 2 jave pushime per Krishtlindjet dhe 1 jave provime nga 21–28 shkurt. Gjate semestrit te dyte studentet kane 7 jave mesim, 13 jave praktike dhe 2 jave provime nga 20 qershor– 4 korrik.

Ne vitin e trete akademik studentet kryejne 10 jave mesimore ne semestrin e pare, 7 jave praktike, 2 jave pushime per Krishtlindjet dhe 1 jave provime nga 20–28 shkurt. Gjate semestrit te dyte studentet kane 8 jave mesim, 13 jave praktike dhe 3 jave provimet perfundimtare nga 15 Qershor–10 Korrik.

Studentet ne perfundim te studimeve 3-vjeçare (Bachelor) marrin listen e notave te lendeve te grupuara ne module, diplomen dhe programin e studimit.

Titulli i Diplomes – TEKNIK IMAZHERI-RADIOLOGJI
CIKLI I PARE - B a c h e l o r

Programi mesimor 2013-2014

QËLLIMET E KURSIT	Kursi i Diplomimit të nivelit të I ^{re} (<i>Bachelor</i>) në degen TEKNIK IMAZHERI-RADIOLOGJI ka si qëllim të formoj teknik qe do te punojne se bashku me mjekun radiolog ne sherbimet spitalore dhe ambulatorore.
KOHEZGJATJA E KURSIT	Kursi zgjat tre vjet dhe ndahet ne 6 semestra te cilet ndahen ne modulet perkatese. Pjesemarrja në leksione eshte e detyrueshme ne masen 70% ndersa seminarret dhe praktikat ne masen 100%. Raporti leksione/seminare eshte 1 me 3 ose 1 me 4 sipas lendes. Ne fund te çdo moduli studenti shlyen lendet perkatese (te detyrueshme) me nje provim. Kursi mbyllet me një provim final që vlerëson aftësite profesionale te integruara te teknikut te imazherise te ardhshem, dhe shoqërohet me lëshimin e një Diplome Universitare të nivelit të I ^{re} (<i>Bachelor</i>) me titullin TEKNIK IMAZHERI-RADIOLOGJI.
KËRKESAT SPECIFIKE DHE KRITERET E PRANIMIT NË VITIN E I^{re}	1. Të ketë mbaruar Shkollën e Mesme 2. Raport mjeksor për aftësinë e tij psikiko – fizike 3. Përzgjedhen nëpërmjet një testimi me shkrim
KUFIJTË E TEKNIKUT TE RADIOLOGJISE	Të diplomuarit në degen TEKNIK IMAZHERI-RADIOLOGJI në bashkëpunim të drejtpërdrejt me mjekun, jane punonjes shendetsor pergjegjes ne strukturat spitalore dhe ambulatorore (publike ose private).

VITI I PARE (2013-2014) - Kredite 60

Semestri i I^{re} - 30 kredite

Kodi	Modulet e integruara	ORE NE AUDITOR	ORE NE TOTAL	KREDITE
RA1 - 1	MATEMATIKA, FIZIKA, STATISTIKA DHE INFORMATIKA	96	200	8
	Analize matematikore	24	50	2
	Fizike e përgjithshme	24	50	2
	Statistika mjekesore	24	50	2
	Informatike	24	50	2
RA1 - 3	Kimia, biokimia , biologjia dhe histologjia	54	112.5	4.5
	Kimi e përgjithshme dhe inorganike	18	37.5	1.5
	Kimi organike dhe biokimia	12	25	1
	Biologji e aplikuar: radiobiologjia dhe histologjia	24	50	2
RA1 - 4	Anatomia normale	108	225	9
	Anatomia normale I	24	50	2
	Anatomi normale II	24	50	2
	Anatomi normale III	24	50	2
	Anatomi radiologjike I	36	75	3

RA1 -P	Praktika laboratorike	212.5	8.5
	Totali		30

Semestri i II^{te} - 30 kredite

Kodi	Modulet e integruara	Ore ne auditor	Ore ne total	Kredite
RA2 - 1	Anatomi –fizio-patologjia	54	112.5	4.5
	Fiziologji normale	18	37.5	1.5
	Anatomi radiologjike II	24	50	2
	Patologji e përgjithshme (semundje te brendshme)	12	25	1
RA2 – 2	Aparaturat radiologjike dhe kontrolli i cilesise	66	137.5	5.5
	Matesat elektrike dhe elektronike: Besueshmeria e kontrollit te cilesise	18	37.5	1.5
	Fizika e aplikuar: parimet fizike te instrumentave	18	37.5	1.5
	Fizika e aplikuar: Fizika e vjeter dhe nukleare (berthamore)	18	37.5	1.5
	Higjena e përgjithshme dhe e aplikuar	12	25	1
RA2 – 3	Teknikat diagnostikuese nepermjet imazheve I	66	137.5	5.5
	Radiologji I	12	25	1
	Radiologji II	18	37.5	1.5
	Radiologji III	18	37.5	1.5
	Mjekesia nukleare I	18	37.5	1.5
RA2 - 4	ANGLISHTE SHKENCORE	30	62.5	2.5
RA2-P	Praktike laboratorike	300		12
	Totali	750		30

VITI I DYTE (2013-2014) - Kredite 60

Semestri i I^{re} - 30 kredite

Kodi	Modulet e integruara	Ore ne auditor	Ore ne total	Kredite
RB1 - 1	Teknikat diagnostikuese nepermjet imazheve II	72	150	6
	Radiologji IV	36	75	3
	Fizika e aplikuar: hyrje ne bioimazhe	36	75	3
RB1 - 2	Informatika dhe arkivimi	72	150	6
	Sistemi i përpunimit informatike: informatika dhe arkivimi	36	75	3
	Diagnostika nepermjet imazheve	36	75	3
RB1 - 3	Mjekesia ne pune	60	125	5
	Organizim shendetesor	24	50	2
	Mjekësia ne pune	36	75	3
RB1 - P	Praktika laboratorike	325		13
	TOTALI	750		30

Semestri i II^{te} - 30 kredite

Kodi	Modulet e integruara	Ore ne auditor	Ore ne total	Kredite
RB2 – 1	Fizika e aplikuar e instrumentave	96	200	8
	Bioinxhinjieria: elektronika dhe informatika	36	75	3
	Fizika e aplikuar: Parimet fizike te instrumentave Mjeko-Nukleare	36	75	3
	Fizika e aplikuar: Parimet fizike shendetesore dhe vlerësimi i kontrollit te cilesise	24	50	2
RB2 - 2	Radiobiologjia dhe mbrojtja ndaj rrezeve	48	100	4
	Radiobiologjia	24	50	2
	Mbrojtja ndaj rrezeve	24	50	2
RB2 - 3	Radioaktivitetit	60	125	5
	Farmakologjia: Ilacet radioaktive dhe radiokimia	24	50	2
	Mjekesia nukleare: Radioterapia mjekonukleare	36	75	3
RB2 - 4	LENDE ME ZGJEDHJE	36	75	3
	Radiologjia konvencionale	18	37.5	1.5
	Mamografia	18	37.5	1.5
RB2 - P	Praktike laboratorike	250		10
	Totali	750		30

VITI I TRETE (2013-2014) - Kredite 60

Semestri i I^{te} - 30 kredite

Kodi	Modulet e integruara	Ore ne auditor	Ore ne total	Kredite
RC1 - 1	Teknikat diagnostikuese nepermjet imazheve II	90	187.5	7.5
	Diagnostika nepermejt imazheve : imazhet tradicionale	24	50	2
	Diagnostika nepermejt imazheve: teknikat tomografike US dhe CT	24	50	2
	Diagnosotika nepermjet imazheve : radiografia e kompjuterizuar	18	37.5	1.5
	Diagnostika nepermjet imazheve: radiologjia e detajeve te larta	24	50	2
RC1 - 2	Prodhimi dhe trajtimi i imazheve diagnostiko	54	112.5	4.5
	Perpunimi i imazheve dixhitale	18	37.5	1.5
	Teknikat e diagnostikimit RM	18	37.5	1.5
	Teknikat e studimit anatomik dhe funksional	18	37.5	1.5
RC1 - 3	Bioetika , deontologjia, etika profesionale	66	137.5	5.5
	Mjekesia ligjore	18	37.5	1.5
	Pergjegjsia profesionale TRM	24	50	2
	Institucioni i te drejtes administrative: biotika , deontologjia profesionale	24	50	2
RC1 - P	Praktikat laboratorike	325		13
	TOTALI	750		30

Semestri i II^{te} - 30 kredite

Kodi	Modulet e integruara	Ore ne auditor	Ore ne total	Kredite
RC2 – 1	Teknikat ne radioterapi	72	150	6
	Radioterapia: teknikat	18	37.5	1.5
	Teknikat: përshpejtuesi linear	18	37.5	1.5
	Dozat ne radioterapi	24	50	2
	Imazhet 3 D per radioterapi dhe stereotaksia	12	25	1
RC2 – 2	Teknikat ne mjekesine nukleare II	66	137.5	5.5
	Mjekesia nukleare II	24	50	2
	Teknikat e terapise mjekonukleare	18	37.5	1.5
	Siguria ne përgatitjen e ilaçeve radioaktive	24	50	2
RC2 - 3	Gjuhe e huaj	24	50	2
	Anglishte shkencore	24	50	2
RC2 -P	Praktika laboratorike	262.5		10.5
	Diplome	150		6
	Totali	750		30

Shenim: Shkronja e pare e kodit te modulit perfaqeson titullin e diplomes (R-Teknik radiologjie), shkronja e dyte perfaqeson vitin (A-viti i I^{re}, B-viti i II^{re} dhe C-viti i III^{re}), numri i pare perfaqeson semestrin dhe numri i dyte modulimin (ku eshte P praktike).

VITI I PARE ANALIZE MATEMATIKORE

Sistemi	I ri (sipas Bolonjes)
Fusha e Formimit	Lende profesionale baze
Diploma	Teknik radiologjie
Semestri	I
Kredite / ore ne auditor/ore total	2 kredite/24/50 ore
Pershkrimi i kursit	Objektivat e kursit: Qëllimi i lëndës është të njohë studentet me njohuri bazë në Matematikë për ti aftësuar ata, ne orientimin ne situata matematikore ne lendet e tjera dhe gjate ushtrimit te profesionit. Programi: Pasqyrimet. Llojet e tyre. Vargu numerik. Limiti i tij. Serite numerike. Kriteria te konvergences se tyre. Funksioni. Limiti, vazhdueshmeria dhe derivati i tij. Elemente te njehsimit kombinator.
Metoda didaktike	Leksion teorik, seminare dhe detyra kontrolli.
Menyra e veresimit	Kontroll i vazhdueshem neper seminare , 2 detyra kontrolli si dhe provim ne fund te modulit.
Shenime	Frekuentimi i rregullt eshte kusht i domosdoshem dhe pjesemarrja ne te 2 detyrat e kontrollit.

FIZIKA E PERGJITHSHME

Sistemi	I ri (sipas Bolonjes)
Fusha e Formimit	Lende profesionale baze
Diploma	Teknik radiologjie
Semestri	I
Kredite / ore ne auditor/ore total	2 kredite/24/50 ore
Pershkrimi i kursit	Objektivat e kursit: Të kuptuarit e dukurive dhe ligjeve të fizikës është thelbësor në përshkrimin e disa proceseve biologjike dhe në zhvillimin e teknikave moderne të ekzaminimeve dhe terapive mjekësore. Ky kurs zhvillohet me qëllim që t'u japë studentëve fizioterapistë mundësinë e të kuptuarit të ligjeve fizike që lidhen me studimet e tyre dhe me rolin e ardhshëm të tyre si fizioterapistë.

	Ky kurs do t'u krijojë mundësinë studentëve të kuptojnë bazat e elektricitetit dhe elektronikës mjekësore si dhe aplikimet në instrumentat elektroterapistë. Programi: Kinematika, Dinamika, ligjet përkatëse. Energjia, Puna dhe fuqia. Puna e muskujve. Deformimi i trupave: shformimet, Tipet e shformimeve, Deformimet në strukturat e ngurta biologjike. Mekanika e lëngjeve: Hidrostatika: parimi i Arkimedit. Tensioni i gjakut dhe faktori hidrostatik. Hidrodinamika: ekuacioni i mosshkëputjes së çurkës, ligji i Bernulit dhe aplikime të tij. Lëngjet realë dhe forcat e fërkimit, viskoziteti. Viskoziteti i gjakut dhe pasojat e tij Bazat fizike të sistemit kardioqarkullues: elasticiteti i enëve të gjakut. Puna e zemrës. Elementë të termodinamikës: Sistemet termodinamike Aplikime në sistemet e qenieve të gjalla. Lëkundjet dhe valët: Tipe të ndryshme valësh. Valët zanore dhe karakteristikat e tingullit. Ultratingujt. Aplikime në biomjekësi. Fusha elektrike, potenciali i fushës, kondensatorët. Ligji i Ohmit. Efekti i rrymës së vazhduar në trupin e njeriut. Aplikimet. Rryma alternative, aplikimet terapeutike të rrymës alternative. Magnetizmi: fusha magnetike dhe karakteristikat e saj, dipoli magnetik, materialet magnetikë dhe jomagnetikë. Elektromagnetizmi: dukuria e induksionit elektromagnetik, ligji i Lencit, Imazheria mjekësore: teknika të ndryshme imazhimi; RMB. Ekografia, TAC, radiografia me rreze X.
Metoda didaktike	Leksion teorik, seminare dhe detyra kontrolli.
Menyra e veresimit	Kontroll i vazhdueshëm neper seminare , 2 detyra kontrolli si dhe provim ne fund te modulit.
Shenime	Frekuentimi i rregullt është kusht i domosdoshëm dhe pjesëmarrja në të 2 detyrat e kontrollit.

STATISTIKA MJEKËSORE

Sistemi	I ri (sipas Bolonjes)
Fusha e Formimit	Lende e formimit te pergjithshem (me zgjedhje)
Diploma	Teknik radiologjie
Semestri	I
Kredite / ore ne auditor/ore total	2 kredite/24/50 ore
Pershkrimi i kursit	Objektivat e kursit: njohja me konceptet baze te statistikes mjekesore me qellim lehtesimin e perdorimit te saj ne te ardhmen ne instituconet ku do te punojne. Programi: Hyrje në statistikë: Objekti i studimit të Statistikës. Karakteristikat e popullatave. Probabiliteti si koncept themelor në Statistikë. Përshkrimi i të dhënave: Llojet e të dhënave. Të dhënat kategorike. Shkallët e “përziera”. Të dhënat metrike. Marrja e mostrës (kampionit) për studim: Karakteristikat e mostrës. Metodën e zgjedhjes së mostrës. Marrja e mostrës në dy faza. Marrja e mostrës në shumë faza. Madhësia e mostrës. Madhësitë e prirjes qëndrore dhe madhësitë e dispersionit: Variacioni i të dhënave. Mesatarja aritmetike. Mediana. Moda. Njehësimi i variacionit. Disa “veti” të mesatares aritmetike dhe të shmangies standarde. Llogaritja e variancës në mostrat me madhësi të “vogël”. Shkallët e lirisë. Shpërndarja normale: Variacioni i të dhënave. Shpërndarja normale. Vetë e shpërndarjes normale standarte. Njësitë standarte. Gabimi standard dhe intervalet e besimit: Nevoja e studimit të mostrave (kampionëve). Saktësia e mesatares së mostrave. Gabimi standard. Intervali i besimit. Shpërndarja “t” e Studentit dhe krahasimi i vlerave mesatare: Shpërndarja “t” (e Studentit). Krahasimi i vlerës mesatare të mostrës me një standard të njohur. Krahasimi i vlerave mesatare në dy grupe. Analiza e të dhënave cilësore: Të dhënat sasiore kundrejt të dhënave cilësore. Rezultatet e vëzhguara kundrejt rezultateve të pritshme. Testi (hi-katror). Lidhja mes ndryshorëve numerikë-korrelacioni: Shoqërimet mes ndryshorëve numerikë. Njehësimi i ko-variancës. Koeficienti i korrelacionit. Interpretimi i koeficientit të korrelacionit.
Metoda didaktike	Leksion teorik, seminare dhe detyra kontrolli.
Menyra e veresimit	Kontroll i vazhdueshëm neper seminare , 2 detyra kontrolli si dhe kolokuim ne fund te modulit.
Shenime	Frekuentimi i rregullt është kusht i domosdoshëm dhe pjesëmarrja në të 2 detyrat e kontrollit.

INFORMATIKE

Sistemi	I ri (sipas Bolonjes)
Fusha e Formimit	Lende e formimit te pergjithshem (me zgjedhje)
Diploma	Teknik radiologjie
Semestri	I

Kredite / ore ne auditor/ore total	2 kredite/24/50 ore
Pershkrimi i kursit	Objektivat e kursit: njohta me konceptet baze te informatikes dhe me aplikimet e principeve informatike ne analizen e fenomeneve biologjike. Programi: Hyrje ne Informatike. Njohuri te pergjithshme : Hardeare. Njohuri te pergjithshme : Softeare. Hyrje ne MS-DOS. MS-DOS. Eindoos. Microsoft Eord. Microsoft Excel.
Metoda didaktike	Leksion teorik, seminare dhe detyra kontrolli.
Menyra e veresimit	Kontrolli i vazhdueshem neper seminare , 2 detyra kontrolli si dhe kolokium ne fund te modulit.
Shenime	Frekuentimi i rregullt eshte kusht i domosdoshem dhe pjesemarrja ne te 2 detyrat e kontrollit.

KIMI E PERGJITHSHME DHE INORGANIKE

Sistemi	I ri (sipas Bolonjes)
Fusha e Formimit	Lende profesionale baze
Diploma	Teknik radiologjie
Semestri	I
Kredite / ore ne auditor/ore total	1.5 kredite/18/37.5 ore
Pershkrimi i kursit	Objektivat e kursit: Për formimin e plotë të një Tekniku Laboratori janë të domosdoshme njohja me disa nocione bazë të kimisë. Kimia është një disiplinë formuese në grupin e shkencave egzakto e cila jep sqarime mbi dukuri dhe procese jo vetëm kimike, por edhe të shkencave të tjera. Programi: HYRJE NË KIMI Analiza elementare; Individi kimik Masa molekulare; Ekuivalenti kimik Reaksionet kimike; Barazmi i reaksioneve kimike Rendimenti i reaksionit kimik Entalpia e reaksioneve kimike Elementet e grupeve A dhe të grupeve B Rrezja e atomeve Vetitë oksido-reduktuese Elektronegativiteti dhe variacioni i tij në sistemin periodik LIDHJA KIMIKE Orbitalet atomike Orbitalet molekulare Lidhja kimike; Energjia e lidhjes kimike Llojet e lidhjeve kimike Ekuilibrat kimikë Ligji i bashkëveprimit të masave Rendi i reaksionit Ndikimi i temperaturës në shpejtësinë e reaksioneve kimike Mekanizmat e reaksioneve kimike (Reaksionet e thjeshta, komplekse, zinxhir, radiokimia) Kataliza TRETËSIRAT Hollimi i tretësirave; Ligji i Hosvaldit Ekuilibrat jonikë Ekuilibri i ujit; pH Indikatorët acido bazikë pH i acideve dhe bazave të forta pH i acideve dhe bazave të dobëta Tretësirat buferike, pH i tyre Titullimi acido-bazik; Lakoret e titullimit Titullimi i acideve të fortë me baza të forta (anasjelltas); Lakoret e titullimit Titullimi i acideve të dobët me baza të forta (anasjelltas); Lakoret e titullimit Titullimi redox; Lakoret e titullimit Precipitimi; Produkti i tretshmërisë KOMPONIMET KOMPLEKSE Emërtimi, struktura dhe ndërtimi i përbërjeve komplekse Lidhja valente Konstantet e formimit të komponimeve komplekse Shpërbashkimi i komponimeve komplekse në tretësira Përcjellshmëria elektrike Elektroliza Elementi galvanic Potenciali i elementit galvanic Korrozioni
Metoda didaktike	Leksion teorik, seminare dhe detyra kontrolli.
Menyra e veresimit	Kontrolli i vazhdueshem neper seminare , 2 detyra kontrolli si dhe provim ne fund te modulit.
Shenime	Frekuentimi i rregullt eshte kusht i domosdoshem dhe pjesemarrja ne te 2 detyrat e kontrollit.

KIMI ORGANIKE DHE BIOKIMIA

Sistemi	I ri (sipas Bolonjes)
Fusha e Formimit	Lende e formimit te pergjithshem (me zgjedhje)
Diploma	Teknik radiologjie
Semestri	I
Kredite / ore ne auditor/ore total	1 kredite/12/24 ore
Pershkrimi i kursit	Objektivat e kursit: njohta e studentit me principet themelore te biokimise si dhe perdorimi i ketyre principeve per te analizuar fenomenet qe lidhen me shkencen mjekesore. Mesimi nga studentet i perdorimit te principeve te ketyre shkencave dhe i teknologjise moderne per te vleresuar parametrat kryesore fiziologjike dhe patologjike mjekesore. Programi: Biokimia, objekti dhe aplikimi i saj. Proteinat, funksioni dhe ndertimi i tyre. Aminoacidet, njesia ndertimore e proteinave. Klasifikimi i aminoacideve. Struktura primare, sekondare, terciare, kuaternare e proteinave. Reaksionet me ngjyre te proteinave dhe interpretimi i tyre mjekesor. Elektroforeza si metode e fraksionimit te proteinave. Proteinat e vecanta dhe interpretimi i tyre klinik. Urea dhe interpretimi klinik i saj. Kreatina dhe kreatinina, interpretimi klinik i tyre. Acidi urik dhe

	interpretimi klinik i tij. Enzimat, klasifikimi dhe shpejtesia e reaksioneve enzimatiqe. Enzimat dhe izoenzimat, klasifikimi dhe interpretimi mjekesor. Glucidet, klasifikimi dhe rendesia e tyre. Monosaharidet, glukoza. Perfaqesuesi kryesor i tyre dhe interpretimi klinik. Disaharidet, perfaqesuesit e tyre. Polisaharidet ndertimore dhe rezerve. Lipidet, klasifikimi dhe rendesia. Acidet e larta yndyrore si perberes te lipideve te perbera. Lipidet e thjeshta, kolesterolit. Lipidet e perbera, trigliceridet, interpretimi klinik. Lipoproteinat transportuese te lipideve dhe rendesia e tyre klinike. Ekuilibri Acido-Bazik. Rendesia e percaktimit te tij. Elektrolitet, Na, K, Ca, P, Cl. Rendesia e percaktimit te tyre. Hormonet, klasifikimi dhe rendesia e tyre. Hormonet e gjendres Tiroide. Gjendra Surenale dhe hormonet e prodhuara prej saj. Hormonet Seksuale. Pankreasi dhe hormonet e prodhuara prej saj. Insulina dhe roli i saj ne organizem. Shkaqet e mungeses se Insulines. Vitaminat, roli dhe rendesia e tyre. Vitamina A dhe B. Vitaminat e grupit B. Vitamina C dhe K. Vitaminet PP dhe E. Rendesia e tyre. Gjaku dhe faktoret e koagulimit. Menyra e marrjes se gjakut dhe antikoagulimi.
Metoda didaktike	Leksion teorik, seminare dhe detyra kontrolli.
Menyra e veresimit	Kontroll i vazhdueshem neper seminare , 2 detyra kontrolli si dhe kolokium ne fund te modulit.
Shenime	Frekuentimi i rregullt eshte kusht i domosdoshem dhe pjesemarrja ne te 2 detyrat e kontrollit.

BIOLOGJI E APLIKUAR: RADIOBIOLOGJIA DHE HISTOLOGJIA

Sistemi	I ri (sipas Bolonjes)
Fusha e Formimit	Lende e formimit te pergjithshem
Diploma	Teknik radiologjie
Semestri	I
Kredite / ore ne auditor/ore total	2 kredite/24/50 ore
Pershkrimi i kursit	Objektivat e kursit: njohja e studentit me principet themelore te biologjise si dhe perdorimi i ketyre principeve per te analizuar fenomenet qe lidhen me shkencen mjekesore. Programi: Hyrje ne Biologji, objekti, metodat e studimit te shkencave biologjike. Karakteristikat e Njeriut. Gjallesat nje dhe shume qelizore. Rendesia e saj. Bazat kimike te se gjalles. Perberesit kimike, inorganike, organike. Karbohidratet, lyrerat, acidet lyrore, prostoglandinat, steroidet, glikolipidet, glikoproteinat, proteinat, vitaminat, acidet nukleike. Qelizat dhe perberesit e saj. Citologjia dhe teoria qelizore, forma qelizore, qeliza prokariote eukariote, struktura qelizore, struktura dhe funksioni i membranave qelizore, modifikimet, veshjet sekondare te cipes qelizore, format e pershkueshmerise qelizore, endocitoza, roli i pompave jonike ne mjekesi. Organelet, berthama, rjeti endoplazmatik, aparati i Golxhit, mitokondria, kloroplastet, lizozomet, peroksizomet, organelet pa mebrane, citoskeleti, mikrofilamentet, fijet e ndermjetme, mkrotubula, fijet e trasha, centriolet, ciljet, flagjeli, ribozomet. Rruget e metabolizmit qelizor, energjia qelizore, reaksionet metabolike, komponimet me energji te larte, enzimat, frymemarrja qelizore, glikoliza, cikli i krebsit, fosforilimi oksidativ dhe sistemi i transportit te elektroneve. Jeta dhe ndarja qelizore. Cikli jetesor i qelizave, interfaza, mitoze, ndryshimet e ndarjes se qelizave tek bimet, mejoza. Bazat e trashegimise. Trashegimia e tipareve, gjenotipi dhe fenotipi, kryqezimet monovibride, ligjet e Mendelit, kryqezimet dihibride, interpretimi i ligjeve te Mendelit. Alelet e shume fishta, grupet e gjakut. Kromozomet dhe gjenetika humane. Kromozomet seksuale, crregullimet gjenetike te njeriu, crregullimet autizomike, crregullimet seksuale. Gjenetika e popullatave. Funksionet e AND-se dhe sinteza e proteinave. Struktura dhe funksioni i AND-se. Nga AND-a tek proteinat. Struktura dhe funksioni i ARN-se. Transkriptimi nga AND tek ARN. Kodi gjenetik. Translatimi i ARNm. Sinteza e proteinave. Mutacionet. Natyra, shkaqet, tipet e tyre. Faktoret mutagjene. Rregullimi i aktivitetit te gjeneve. Kontrolli feed-back negativ, kontrolli me repressor, kontrolli me inductor. Bioteknologjia dhe AND rikombinante. Bioteknologjia klasike. Kulturat qelizore shtazore. Perdorimi i kulturave qelizore ne bioteknologji. Metodatat qe perdoren ne bioteknologjine klasike per prodhimin e antibiotikeve. Bioteknologjia molekulare. Krijimi i AND-rikombinante. Prodhimi i antibiotikeve me ane te metodave AND-rikombinante. Perfritimi i qenieve te gjalla me ane te AND-rikombinante. Teknikat e klonimit. Rendesia e klonimit dhe debatet rreth tij. Anatomia dhe fiziologjia e vertebroreve. Evolucionin e humaneve. Taksonomia humane. Te perbashketat dhe te vecantat midis kafsheve dhe humaneve. Teorite per zhvillimin e humaneve. Indet, organet, sistemet e organeve, indi epithelial, indi lidhor, indi muskulator, indi nervor. Homeostaza dhe roli i saj ne percaktimet patologjike. Sistemi muskulator, skeletik, nervor, endokrin, i qarkullimit te gjakut, limfatik, imunitar, i frymarrjes, i tretjes, i ndijimit i ekskretimit dhe sistemi i riprodhimit. Zhvillimi human, lindja, rritja, mosha e

	mesme dhe plakja. Tiparet antropometrike te humaneve. Ekologjia, ekosistemet, faktoret ekologjik, reaksionet homotipik, ferromonet, reaksionet heterotipike. Zinxhoret ushqimore, nocioni i biomases dhe prodhimtarise, popullatat, mjedisi, popullimi, aftesa riprodhuese, lindshmeria, vdekshmeria, tabelat e jetegjatesise, lakoret e jetegjatesise, piramidat moshore. Histologjia: objekti, historiku, metodat e studimit. Citologjia. Indi epithelial. Indi lidhor. Gjaku. Palca e kockave dhe hemopoeza. Indi limfoid. Indi kercor dhe kockor. Indi muskular. Indi nervor. Enet e gjakut dhe zemra. Sistemi respirator. Aparati tretes: gjuha, tonsilat, gjendrat e peshtymes. Dhemb. Aparati tretes: ezofagu, stomaku, zorret. Aparati tretes: melcia, pankreasi. Gjendrat me sekretim te brendshem. Sistemi urinar. Lekura. Sistemi riprodhues femeror. Sistemi riprodhues mashkullor. Syri. Veshi.
Metoda didaktike	Leksion teorik, seminare dhe detyra kontrolli.
Menyra e veresimit	Kontroll i vazhdueshem neper seminare , 2 detyra kontrolli si dhe kolokium ne fund te modulit.
Shenime	Frekuentimi i rregullt eshte kusht i domosdoshem dhe pjesemarrja ne te 2 detyrat e kontrollit.

ANATOMI NORMALE I

Sistemi	I ri (sipas Bolonjes)
Fusha e Formimit	Lende profesionale baze
Diploma	Teknik radiologjie
Semestri	I & II
Kredite / ore ne auditor/ore total	2 kredite/24/50 ore
Pershkrimi i kursit	Objektivat e kursit: studenti duhet te mesoje dhe te kuptoje strukturen e trupit te njeriut, ne nivel makroskopik , mikroskopik dhe ultramikroskopik, si dhe mekanizmat e zhvillimit normalt dhe te anomalive te bashkelindura. Te njohje karakteristikat morfologjike te indeve dhe te strukturave subqelizore te organezmit te njeriut. Programi: Hyrje ne anatomi. Shtylla kurrizore ne teresi. Kafazi i krahavorit. Os parietale, oksipitale, sfenoidale. Os temporale. Maksila dhe kockat e tjera te fytyres. Mandibula, os hyoideum. Basis crani interna, regjioni i kafkes. Skeleti i gjymtyreve te siperme. Pelvisi. Skeleti i gjymtyreve te poshteme. Lidhjet kockore, (shtylla kurrizore). Lidhjet kockore, (anesite e siperme). Lidhjet kockore, (anesite e poshtme, legeni). Muskujt e toraksit, abdominale, kokes,qafes. Fasciet e qafes dhe topografia. Muskujt e supit dhe te krahut, parakrahut, pelvisit. Diametrat e pelvisit. Muskujt e kofshes, anesive te poshtme.
Metoda didaktike	Leksion teorik, seminare dhe detyra kontrolli.
Menyra e veresimit	Kontroll i vazhdueshem neper seminare , 2 detyra kontrolli si dhe provim ne fund te modulit.
Shenime	Frekuentimi i rregullt eshte kusht i domosdoshem dhe pjesemarrja ne te 2 detyrat e kontrollit.

ANATOMI NORMALE II

Sistemi	I ri (sipas Bolonjes)
Fusha e Formimit	Lende profesionale baze
Diploma	Teknik radiologjie
Semestri	I & II
Kredite / ore ne auditor/ore total	2 kredite/24/50 ore
Pershkrimi i kursit	Objektivat e kursit: studenti duhet te mesoje dhe te kuptoje strukturen e trupit te njeriut, ne nivel makroskopik , mikroskopik dhe ultramikroskopik, si dhe mekanizmat e zhvillimit normalt dhe te anomalive te bashkelindura. Te njohje karakteristikat morfologjike te indeve dhe te strukturave subqelizore te organezmit te njeriut. Programi: Topografia e anesive te poshtme. Goja, dhembet, gjuha, gjenderat e peshtymes. Faringu, ezofagu. Stomaku, zorra e holle, zorra e trashje. Hepari, vesika felle. Pankreasi. Kaviteti abdominal, peritoneal. Aparati respirator. Aparati urinar. Aparati genital, femeror dhe mashkullor. Zemra. Arteriet. Venat dhe sistemi limfatik.
Metoda didaktike	Leksion teorik, seminare dhe detyra kontrolli.
Menyra e veresimit	Kontroll i vazhdueshem neper seminare , 2 detyra kontrolli si dhe provim ne fund te modulit.
Shenime	Frekuentimi i rregullt eshte kusht i domosdoshem dhe pjesemarrja ne te 2 detyrat e kontrollit.

ANATOMI NORMALE III

Sistemi	I ri (sipas Bolonjes)
Fusha e Formimit	Lende profesionale baze
Diploma	Teknik radiologjie
Semestri	I & II
Kredite / ore ne auditor/ore total	2 kredite/24/50 ore
Pershkrimi i kursit	Objektivat e kursit: studenti duhet te mesoje dhe te kuptoje strukturen e trupit te njeriut, ne nivel makroskopik , mikroskopik dhe ultramikroskopik, si dhe mekanizmat e zhvillimit normalt dhe te anomalive te bashkelindura. Te njohe karakteristikat morfologjike te indeve dhe te strukturave subqelizore te orqanizmit te njeriut. Programi: Palcae kurrizit dhe palca e zgjatur (madulla oblongata). Truri i vogel (cerebellum), truri i mesem (mesencefalon), ganglionet bazale. Truri (cerebrum), korja e trurit. Sistemi ventrikular dhe ai i qarkullimit te likuorit cerebro-spinal. Nervat kraniale (I-VII), (VIII-XII), spinale (pleksi cerviko-brakial), spinale (pleksi lumbo-sakral). Sistemi nervor vegjetativ. Sistemi neuroendokrin. Syri. Veshi. Lekura.
Metoda didaktike	Leksion teorik, seminare dhe detyra kontrolli.
Menyra e veresimit	Kontroll i vazhdueshem neper seminare , 2 detyra kontrolli si dhe provim ne fund te modulit.
Shenime	Frekuentimi i rregullt eshte kusht i domosdoshem dhe pjesemarrja ne te 2 detyrat e kontrollit.

ANATOMI RADIOLOGJIKE I

Sistemi	I ri (sipas Bolonjes)
Fusha e Formimit	Lende profesionale baze
Diploma	Teknik radiologjie
Semestri	I & II
Kredite / ore ne auditor/ore total	3 kredite/36/75 ore
Pershkrimi i kursit	Objektivat e kursit: Sudneti duhet te njohe aspektin radiologjik te strukturave te ndryshme te trupit dhe menytrat e orientimit ne radiologji Programi: Anatomia radiologjike craniale, os frontalis, os parietale, os occipitale Anatomia radiologjike e sinuseve paranasale, orbitave dhe os mandibula Anatomia radiologjike e kollones vertebrale, pars cervicalis, pars torakalis, pars lumbaris, pars sacrokoksigealis Anatomia radiologjike e sternumit dhe artikulationit sternoclavikular Anatomia radiologjike e humerusit dhe artikulationit scapulo humeral Anatomia radiologjike e artikulationit te berrylit Anatomia radiologjike e pelvisit Anatomia radiologjike e tibias dhe fibules Anatomia radiologjike e humerusit Anatomia radiologjike e tarseve, metatarsave, flangeve Anatomia radiologjike e kavitetit oral Anatomia radiologjike e laringut Anatomia radiologjike e pulmoneve
Metoda didaktike	Leksion teorik, seminare dhe detyra kontrolli.
Menyra e veresimit	Kontroll i vazhdueshem neper seminare , 2 detyra kontrolli si dhe provim ne fund te modulit.
Shenime	Frekuentimi i rregullt eshte kusht i domosdoshem dhe pjesemarrja ne te 2 detyrat e kontrollit.

FIZIOLOGJI NORMALE

Sistemi	I ri (sipas Bolonjes)
Fusha e Formimit	Lende profesionale baze
Diploma	Teknik imazherie
Semestri	II
Kredite / ore ne auditor/ore total	1.5 kredite/18/37.5 ore
Pershkrimi i kursit	Objektivat e kursit: njohja e studentit me funksionet e qelizes, indeve organeve , sistemeve dhe me mekanizmat e kontrollit te ketyre funksioneve. Programi: Funksionet e qelizes, kalimi i lendeve neper membranen qelizore. Homeostaza, ruajtja e mjedisit te brendshem, variabelt fiziologjike konstante dhe jo konstante. Termorregullimi dhe kontrolli hipotalamik, hipotermia dhe hipertermia. Muskujt,

	anatomia funksionale e sarkomerit, fiziologjia e tkurrjes, tkurrja izometrike dhe izotonike. Nervat, ndertimi i nervave periferike dhe roli i mjelines. Sinapset, neurotransmetuesit dhe vecorite e transmetimit sinaptik. Nxitshmeria e neuronit gjate fazave te potencialit te veprimit. Potenciali i qetesise dhe fenomeni i pragut. Somestezia dhe transduktoret si receptore te modaliteteve te ndryshme sensoriale. Gjumi dhe mekanizmat e kujteses, gjendja zgjuar dhe roli i formacionit retikular. Sistemi nervor autonom (simpatiku dhe parasimpatiku). Lidhja neuro-muskulore dhe inervimi i muskulatures somatike, idiokineza dhe holokineza. Shqisa e shikimit, ndertimi i retines, rruget pamore centrale. Funksionet e larta te kores se trurit, specializimi hemisferik dhe te folurit. Automatizmi i muskulatures se miokardit. Elektrokardiograma, valet dhe segmentet si dukuri elektrike, teknika e rregjistrimit. Cikli zemeror, tonet e zemres, ligji i Starlingut. Rregullimi i veprimtarise se zemres, rregullimi homeometrik dhe heterometrik. Frymeshkembimi: mekanizmi i frymemarrjes se jashteme, forcat elastike dhe rezistenca e rugeve te ajrit. Shkembimi i gazeve ne mushkri, raportet ventilim/perfuzion, rregullimi nervor dhe humoral i frymeshkembimit. Motorrika e sistemit tretes: motorika e stomakut, intestinum tenue, intestinum crassum. Funksioni sekretor i sistemit tretes, lengu i stomakut, intestinal, pankreatik dhe biliar. Funksionet e melcise. Funksioni thithes i sistemit tretes, thithja e ujit, elektroliteve dhe lendeve te tjera ushqimore. Shkembimi i lendeve, i karbohidrateve, lipideve dhe proteinave. Ushqyerja dhe rregullimi i saj. Parime te ushqyerjes dietetike. Njohuri te pergjithshme mbi sistemin endokrin. Hormonet, mekanizmi i veprimit te tyre. Gjendra hipofizare, adenohipofiza dhe neurohipofiza, hormoneve perkatese qe sekretohen prej tyre. Tiroidja, sinteza e hormoneve tiroidiene, efektet fiziologjike te tyre dhe rregullimi perkates. Paratiroidja, rregullimi hormonal i metabolizmit kalcik. Gjendrat surenale, efektet fiziologjike dhe mekanizmat e veprimit te hormoneve pankreatike. Gonadet, testikujt dhe ovaret, funksionet fiziologjike te estrogjeneve, progesteronit dhe androgjeneve. Lindja dhe laktacioni, fiziologjia placentare. Hapsirat ujore ne trupin e njeriut, mjedisi osmolar. Anatomia funksionale e veshkes, qarkullimi i gjakut ne veshka, filtrimi glomerular. Funksioni i sistemit tubular, riperthithja dhe sekretimi i lendeve te ndryshme. Jashteqitja e Na, Ca, K, Cl dhe ujit. Hollimi dhe perqendrimi i urines. Anatomia funksionale e traktit te poshtem urinar. Roli i veshkes ne rregullimin e perberjes dhe vrellimit te lengut jashteqelizor dhe perqendrimin e hidrogjenit. Ekuilibri acido-bazik, roli i veshkes dhe i pulmoneve. Funksioni endokrin i veshkes. Gjaku, funksionet dhe perberja, eritrocitet dhe leukocitet. Grupet e gjakut, sistemi ABO dhe Rhesus. Homeostaza dhe fazat e saj. Sistemi imunitar, imuniteti qelizor dhe humoral, roli i limfociteve dhe limfokineve. Qarkullimi limfatik, mekanizmi i prodhimit te limfes dhe funksionet e saj fiziologjike.
Metoda didaktike	Leksion teorik, seminare dhe detyra kontrolli.
Menyra e veresimit	Kontroll i vazhdueshem neper seminare , 2 detyra kontrolli si dhe provim ne fund te modulit.
Shenime	Frekuentimi i rregullt eshte kusht i domosdoshem dhe pjesemarrja ne te 2 detyrat e kontrollit.

ANATOMI RADIOLOGJIKE II

Sistemi	I ri (sipas Bolonjes)
Fusha e Formimit	Lende profesionale baze
Diploma	Teknik radiologjie
Semestri	I & II
Kredite / ore ne auditor/ore total	2 kredite/24/50 ore
Pershkrimi i kursit	Objektivat e kursit: Sudneti duhet te njohet aspektin radiologjik te strukturave te ndryshme te trupit dhe menytrat e orientimit ne radiologji Programi: Stomaku,ndertimi anatomik i tij.Studimi me barium i ezofagut,junksionit kardio-ezofageal dhe stomakut.Kurvaturat major dhe minor,pilor,duodeni Ndertimi i heparit dhe rrugeve biliare,kolecista.Menytrat e ekzaminimeve qe perdoren per studimin e tyre. Pankreasi dhe lieni,menytrat e studimit Veshkat ,ndertimi dhe funksioni i tyre.Menytrat e ndryshme te ekzaminimit sic jan ekografia,Ct dhe pielografia. Ileumi,jejunumi,pjesa I.Ndertimi dhe menytrat e ekzaminimit,patologjite. Ileumi,jejunumi,pjesa II.Ndertimi dhe menytrat e ekzaminimit,patologjite. Ndertimi i kolonit.Patologjite e kolonit ,menytrat e ekzaminimit. Vezika urinare.Ndertimi i vezikes,menytrat e ekzaminimit te saj.Uterusi dhe ovaret.Ndertimi ,funksioni,menytrat e ndryshme te ekzaminimit Prostata,anatomia,funksionimi dhe menytrat e ekzaminimit Hapsira peritoneale dhe retroperitoneale,menytrat e ekzaminimit dhe patologjite.
Metoda didaktike	Leksion teorik, seminare dhe detyra kontrolli.
Menyra e veresimit	Kontroll i vazhdueshem neper seminare , 2 detyra kontrolli si dhe provim ne fund te modulit.

Shenime	Frekuentimi i rregullt është kusht i domosdoshëm dhe pjesëmarrja në të 2 detyrat e kontrollit.
---------	--

PATOLOGJI E PERGJITHSHME (SEMUNDJET TE BRENDSHME)

Sistemi	I ri (sipas Bolonjes)
Fusha e Formimit	Lende speciale
Diploma	Teknik radiologjie
Semestri	II
Kredite / ore në auditor/ore total	1 kredite/36/75 ore
Përshkrimi i kursit	Objektivat e kursit: Lenda synon të jap studenteve njohuritë themelore mbi sëmundjet e brendshme . Programi : Objekti i sëmundjeve të brendshme, ekzaminimi subjektiv; Ekzaminimi objektiv, metodat egzaminuese; Aparati respirator: ekzaminimi subjektiv, objektiv dhe metodat ndihmëse të aparatit respirator; Bronkitet dhe bronkiolitet; Asthma bronkiale dhe bronkiti astmatik; Pneumonia dhe bronkopneumonia; Emfizema, edema pulmonare; Gangrena, absesi dhe infarkti pulmonar; Bronkoektazia dhe pleuritët; T.B.C pulmonar, pneumotoraksi dhe Ca pulmonar; Aparati kardiovaskular: ekzaminimi subjektiv, objektiv dhe metodat ndihmëse të aparatit kardiovaskular; Poliartriti reumatizmal akut dhe veshet e fituara të zemrës; Insuficiencia dhe stenoza e valvulës mitrale; Insuficiencia dhe stenoza e valvulës aortale; Endokarditet; Miokarditet dhe perikarditet; Insuficiencia kardiovaskulare e majtë dhe e djathtë; Cor pulmonar; Crregullimet e ritmit të zemrës; Miokardiopatia arteriosklerotike; Sëmundjet ishemike të zemrës; Infarkti akut i miokardit; Sëmundjet hipertoniqe; Sinkopi kardiak, kolapsi, lipotimia; Sëmundjet reumatizmale: Artriti reumatoid; Lupusi eritematoz dhe sklerodermia; Dermatomioziti dhe panarteriti nodos; Morbus Bekteriev, osteartrozat, periarteritet.
Metoda didaktike	Leksione teorike,seminare,kolokium
Menyra e verësimit	Kontrolli i vazdushëm neper seminare dhe vleresi i në fund të modulit me kolokium
Shenime	Frekuentimi i rregullt është kushte i domosdoshëm dhe pjesëmarrja në detyra kontrolli.

MATESAT ELEKTRIKE DHE ELEKTRONIKE : BESUESHMERIA E KONTROLLI I CILESISE

Sistemi	I ri (sipas Bolonjes)
Fusha e Formimit	Lende e formimit të përgjithshëm
Diploma	Teknik radiologjie
Semestri	II
Kredite / ore në auditor/ore total	1.5 kredite/18/37.5 ore
Përshkrimi i kursit	Objektivat e kursit: Lenda ka synim kryesor të përgatisë studentët me njohuritë themelore të mbi pajisjet matëse dhe të dedektimit të sinjalit, rrymes elektrike dhe madhësive të tjera. Gjithashtu, një pjesë e mirë e lëndës i dedikohet teknikave të kalibrimit dhe kontrollit të cilësive në ambientin e punës Programi : Ngarkesa dhe grimcat e ngarkuara, Fusha elektrostatische në boshllëk. Dukuri, ligje dhe ko themelore. Ligji i Kulonit. Fusha elektrostatische, intensiteti, potenciali, energjia. Përcjellës fushën elektrostatische, kapaciteti elektrik dhe kondensatorët. Fusha elektrike në përcjellës e fushës elektrike, rryma elektrike e vazhduar. Ligji i Omit dhe i Xhaul-Lencit. Qarqet e Pajisjet matëse, ampermetër, voltmetër, ohmmeter, multimetër, Pwrdorimi i tyre. Teoria e përcjellshmërisë elektrike dhe kufizimet e saj. Elektrolitët. Elektroliza. Ligji i Faradeit.. elektrike në trupin e njeriut. Rryma në gaze. Sistemet e dedektimit, cilësitë e pajisjeve de ndertimi dhe funksionimi Fusha magnetike. Ligji Bio-Savar, Forca e Lorencit dhe e Lapl magnetik. Dukuria e induksionit elektromagnetik.Energjia e fushws magnetike, Rryma al Vlerat e castit. Fuqia e rrymws alternative, Rryma alternative në indet e gjalla. Akseleratë gjenertoret, pajisjet e thjeshta matëse të fushave, Fuqia e rrymes alternative. Rryma altë indet e gjalla. Gabimi në matje, vlerësimi i gabimit, korigjimi i vlerave, monitorimi dhe k periodik i vlerave Kalibrimi i pajisjeve elektrike e elektronike, kalibrimi periodik
Metoda didaktike	Leksione teorike,seminare,provim
Menyra e verësimit	Kontrolli i vazdushëm neper seminare dhe vleresi i në fund të modulit me provim
Shenime	Frekuentimi i rregullt është kushte i domosdoshëm dhe pjesëmarrja në detyra kontrolli.

FIZIKA E APLIKUAR :PARIMET FIZIKE TE INSTRUMENTAVE

Sistemi	I ri (sipas Bolonjes)
Fusha e Formimit	Lende e formimit te pergjithshem
Diploma	Teknik radiologjie
Semestri	I
Kredite / ore ne auditor/ore total	1.5 kredite/18/37.5 ore
Pershkrimi i kursit	Objektivat e kursit: Lenda ka synim kryesor të përgatisë studentët me njohuritë themelore të mbi dukrite fizike të ngarkesave, rrymës elektrike, madhësitë, relacionet etj, të kësaj pjese të fizikës Programi : KINEMATIKA Koncepte themelore. Trajektorja , shpejtesia, nxitimi. Projektionet e shpejtësisë dhe të nxitimit në koordinatat karteziene kënddrejta (oxyz). Përbërja e zhvendosjeve, e shpejtësive dhe e nxitimeve. Lëvizja e ndryshuar. Koordinatat vijëpërkulura ortogonale. DINAMIKA E PIKES MATERIALE Dinamika e pikës materiale. Statistika e pikës materiale. Teoremat e dinamikës së pikës. Funksioni potencial, fusha e forcave. Ligji i tërheqjes së gjithësisë. Fusha e gravitacionit. Ligjet e Keplerit. Ekuacionet e lëvizjes së pikës materiale. Goditjet. Ekuacionet e lëvizjes relative të pikës. Kinetika e pikës material jo të lirë dhe fërkimi. Ekuacionet e pikës material jo të lirë. MEKANIKA E TRUPIT TE NGURTE Koncepte të përgjithshme. Lëvizja tejbartëse e trupit të ngurtë. Lëvizja plan-paralele e trupit të ngurtë. Lëvizja e trupit të ngurtë rreth një pike të palëvizshme. Mbledhja e lëvizjeve të trupit të ngurtë Statika e sistemit të pikave materiale dhe trupit të ngurtë. Kushtet dhe ekuacionet e ekuilibrit të trupit të ngurtë. Parimi i zhvendosjeve virtuale. DINAMIKA E TRUPIT TE NGURTE MOMENTI INERCISE. EKUACIONI THEMELORI LEVIZJES RROTULLUESE TE TRUPIT TE NGURTE . ENERGJIA KINETIKE E TRUPIT TE NGURTE. RROTULLIMI LIREI TRUPIT TE NGURTE. BASHKEVEPRIMI GRAVITACIONAL MEKANIKA E TRUPAVE ELASTIKE SHFORMIMET DHE TENSIONET. TIPET E NDRYSHME TE SHFORMIMEVE. LIGJI HUKUT. ENERGJIA POTENCIALE E DEFORMIMIT. MEKANIKA E RRJEDHESVE CILESITE E PERGJITHSHME TE RRJEDHESAVE. LEVIZJA STACIONARE E RRJEDHESVE IDEALE. EKUACIONI BERNULIT. FERKIMI I BRENDESHEMI RRJEDHESVE. LEVIZJA E TRUPAVE NE RRJEDHESA. LEKUNDJET Lekundjet harmonike. Energjia e lekundjeve harmonike. Mbledhja e lekundjeve harmonike. Lekundjet qe shuhen . Lekundjet e detyruara.Kapitulli 1. Hyrje. Ngarkesa dhe grimcat e ngarkuara, Fusha elektrostatiqe në boshllëk. Dukuri, ligje dhe konceptet themelore. FUSHA ELEKTROSTATIKE Ligji i Kulonit. intensiteti, potenciali, teorema e Gausit, relacionet lokale të elektrostatiqës, energjia. Përcjellësit në fushën elektrostatiqe, kapaciteti elektrik dhe kondensatorët. Fusha elektrike në përcjellësa. Energjia e fushes elektrike, rryma elektrike e vazhduar. Ligji i Omit dhe i Xhaul-Lencit. Qarqet e degëzuar, FUSHA MAGNETIKE. Forca e Lorencit dhe induksioni magnetik. Bashkëveprimi i ngarkesave në lëvizje, fusha magnetike dhe përcaktimi i saj. Forca që ushtron fusha magnetike mbi rrymën. Ligji Bio-Savar dhe cirkulacioni i fushës. Puna e forces magnetike. Induksioni elektromagnetik dhe ekuacionet e Maksuellit
Metoda didaktike	Leksione teorike,seminare,provim
Menyra e veresimit	Kontrolli i vazdushem neper seminare dhe vleresi i ne fund te modulit me provim
Shenime	Frekuementimi i rregullt eshte kushte i domosdoshem dhe pjesmarria ne detyra kontrolli.

FIZIKA E APLIKUAR: FIZIKA E VJETER DHE NUKLEARE (BERTHAMORE)

Sistemi	I ri (sipas Bolonjes)
Fusha e Formimit	Lende e formimit te pergjithshem
Diploma	Infermieri e pergjithshme
Semestri	I
Kredite / ore ne auditor/ore total	1.5 kredite/18/37.5 ore

Pershkrimi i kursit	Objektivat e kursit: Ka synim kryesor të përgatisë studentët me njohuritë themelore të mbi dukrite fizike të fizikes berthamore dhe aplikimeve ne mjekesi etj Programi : <i>Optika kuantike.</i> Rrezatimi termik, fotoefekti dhe efekti Kompton. Natyra dualiste e dritës. <i>Spektri i hidrogjenit dhe atomi i Borit.</i> Modeli bërthamor i Radhërfordit. Seritë spektrale të atomit të hidrogjenit. Teoria e Borit për atomin e hidrogjenit. <i>Elementë të mekanikës kuantike.</i> Dualizmi valë-grimcë, hipoteza e de Brojtit. Funksioni valor, ekuacioni i Shredingerit. Relacioni i papërcaktueshmërisë. Gropa potenciale, barriera potenciale dhe efekti tunel. <i>Bazat e mekanikës kuantike të atomit.</i> Atomi i hidrogjenit në teorinë kuantike. Numrat kuantikë. Spini. <i>Molekula.</i> Tipet e lidhjeve molekulare, jonike dhe kovalente. Spektri molekular i rrotullimit dhe i lëkundjeve. <i>Fizika bërthamore.</i> Bërthama atomike dhe energjia e lidhjes. Qendrueshmeria e berthamave <i>Forcat bërthamore dhe modelet bërthamore.</i> <i>Radioaktiviteti</i> natyror dhe artificial, ligji i zberthimit radioaktiv, Reaksionet bërthamore. Grimcat e perftuara, karakteristikat e tyre Zbatime te fizikes berthamore ne mjekesi
Metoda didaktike	Leksione teorike,seminare,provim
Menyra e veresimit	Kontrolli i vazdushem neper seminare dhe vleresi i ne fund te modulit me provim
Shenime	Frekuentimi i rregullt eshte kushte i domosdosshem dhe pjesmarrja ne detyra kontrolli.

HIGJENA E PERGJITHSHME DHE E APLIKUAR

Sistemi	I ri (sipas Bolonjes)
Fusha e Formimit	Lende e formimit te pergjithshem
Diploma	Teknik radiologjie
Semestri	II
Kredite / ore ne auditor/ore total	1 kredit/12/25 ore
Pershkrimi i kursit	Objektivat e kursit: Mjekesia e Punes pergjigjet per vrojtimin e shendetit te njerezve ne mjediset e punes, aksidentet ne pune dhe semundjet profesionale. Nje nga detyrat qe ka Mjekesia e Punes eshte dhe parandalimi i njehershem i te gjithë faktoreve te demshem fizike, kimike, biologjike dhe psikike te shkaktuar nga kushtet e punes dhe prodhimit. Programi : Legjislacioni i Mjekesise se Punes Organizimi i sherbimit te Mjekesise se Punes Ndermarrja, struktura e saj, “organigrama” Aksidente ne pune Semundjet dhe demtimet profesionale Ergonomia dhe fiziologjia e punes Nocione te pergjithshme dhe perkufizime Fiziologjia e punes muskulare Fiziologjia kardiorespiratore dhe puna Detyrimet fiziologjike dhe ambienti i punes Ritmet biologjike dhe puna Semundjet profesionale Helmimet Semundjet e shkaktuara nga zhurmat dhe vibracionet e prodhimit Patologjia e shkaktuar nga ajri i komprimuar Semundjet e shkaktuara nga radiacioni i jonizuar Semundjet e shkaktuara nga pluhurat Pneumokoniozat Dermatozat profesionale Astma profesionale Llojet e ndryshme te kancereve profesionale. Demitmet neuropsikiatrike profesionale Semundjet infektive Ndikimi patolgjik i punes mbi zemren
Metoda didaktike	Leksione teorike,seminare,provim
Menyra e veresimit	Kontrolli i vazdushem neper seminare dhe vleresi i ne fund te modulit me provim
Shenime	Frekuentimi i rregullt eshte kushte i domosdosshem dhe pjesmarrja ne detyra kontrolli.

RADIOLOGJI I

Sistemi	I ri (sipas Bolonjes)
Fusha e Formimit	Lende e formimit te pergjithshem
Diploma	Teknik radiologjie
Semestri	II
Kredite / ore ne auditor/ore total	1 kredite/12/25 ore
Pershkrimi i kursit	Objektivat e kursit: Ne baze te ketij programi studenti duhet te jete ne gjendje te pervetesojë pjesen teorike te Radiologji I fiziologjise Synon qe studenti ne perfundim te programit te jete ne gjendje te kuptojë nocionet mbi radiografine dhe arteriografine si dhe te njihet me metodat radiologjike te ekzaminimit te kokes dhe kollones vertebrale Programi : Metodat e ekzaminimit te craniumit, projektionet standarte te projektionit ne radiologjine konvencionale, udhezime per kilovoltazhin dhe Am Metodat e ekzaminimit te craniumit, projektionet atipike ne ro- konvencionale, udhezime per kilovoltazhin dhe Am/p Metodat e ekzaminimit te pars cervikale te kollones vertebrale, projektionet standarte te projektionit ne ro- konvencionale, udhezime per kilovoltazhin dhe Am Metodat e ekzaminimit te pars torakale te kollones vertebrale, projektionet standarte te projektionit ne ro- konvencionale, udhezime per kilovoltazhin dhe Am Metodat e ekzaminimit te pars lumbare te kollones vertebrale, projektionet standarte dhe atipike ne ro- konvencionale. Projektionet standarte dhe atipike ne radiologjine konvencionale te pelvisit , udhezime per kilovoltazhin dhe Am Cilat jane lendet e kontrastit, ndarja ne grupe, njohja me efektet anesore Cilet jane kontrastet qe perdoren ne radiologjine konvencionale, efektet ne organizem, pergatitja e pacienti per administrimin e kontrastit, marrja e masave per reduktimin e efekteve anesore. Metodat e kryerjes se arterografise se vazave te kokes, pergatitja e pacientit. Projektionet standarte dhe atipike qe perftohen.
Metoda didaktike	Leksione teorike,seminare,provim
Menyra e veresimit	Kontrolli i vazdushem neper seminare dhe vleresi i ne fund te modulit me provim
Shenime	Frekuentimi i rregullt eshte kushte i domosdoshem dhe pjesmarrja ne detyra kontrolli.

RADIOLOGJI II

Sistemi	I ri (sipas Bolonjes)
Fusha e Formimit	Lende e formimit te pergjithshem
Diploma	Teknik radiologjie
Semestri	II
Kredite / ore ne auditor/ore total	1.5 kredite/18/37.5 ore
